

Data 04.02.2026

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS - SHËRBIME

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E TERMAVE TE REFERENCES DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Menaxhimi i mbetjeve te integruara

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 15413000-6;
90513500-1; 90530000-1; 90533000-2

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,930,200 (një milion e nëntëqind e tridhjetë mijë e dyqind) lekë pa
tvsh;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”
i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Albanian Gas Service Company SH.A** ka hartuar
procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e termave të referencës dhe kriterëve për
kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:
 - a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;
 - b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 10

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenet 76, 82 “Formulari
përmbledhës i vetdeklarimit”, në nenin 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për
Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 30/1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për
Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, të ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

*2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të
paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të
paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të
marrëveshjes kuadër.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3 të LPP, si dhe
nenin 43, pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 29/2023
"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e
detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës

elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës është bërë brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe paraqitja e një dëshmie të lëshuar nga administrata tatimore vërteton besueshmërinë dhe kapacitetet financiare që ka një operator ekonomik ofertues nëpërmjet xhiros të realizuar në një nga këto vitet e fundit. Është e rëndësishme që ofertuesi para se të dorëzojë ofertën të kuptojë dhe të vlerësojë aftësitë/mundësitë e tij që lidhen me kapitalin e nevojshëm për ekzekutimin me sukses të një kontrate të kësaj përmase që AK po prokuron.

2.2 Aftësitë teknike:

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit të limit të marrëveshjes kuader.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe në nenin 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit të Marrëveshjes kuader, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën prej 20 % të fondit limit të MK, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një "kompetencë thelbësore", ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit (ose ekuivalente).

Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi Kërkesat e mësipërme janë vendosur bazuar në nenin 79, pika 1 e Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe në nenin 44 “Kërkesat e Cilësisë” të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Nisur nga norma ndërkombëtare që përfaqëson ISO-ja 9001:2015 “Sistemi për Menaxhim të Cilësisë”, aplikohet për kompani të ndryshme përfshirë këtu edhe shoqëritë që ushtrojnë aktivitet tregtar në fushën e menaxhimit të mbetjeve të integruara, pavarësisht madhësisë apo kompleksitetit që ato kanë ose fushës së veprimtarisë që ato ushtrojnë. Vendosja e ISO 9001:2015 na shërben për të na treguar sistemin e administrimit të shoqërisë, zotësinë e operatorëve ekonomikë për zbatimin e kërkesave të vazhdueshëm të tij për të siguruar konformitetin në zbatimin e kërkesave. Disponimi i kësaj ISO-je rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se është e lidhur ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizon konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

Duke qenë se, shërbimet e menaxhimit të mbetjeve që janë të parashikuara në këtë kontratë do të realizohen në qendrat e mirëmbajtjes të AGS sh.a, është e domosdoshme që operatorët ekonomikë ta disponojnë edhe Standartin ISO 14001:2015 “Sistemi manaxhimit të mjedisit”. Kjo ISO është e lidhur me mjedisin dhe ndihmon në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në lidhje me klientet e saj, komunitetin dhe autoritetet kontraktore. Në të njëjtën kohë manaxhimi i duhur i çështjeve lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe parandalimin e ndotjeve ndihmojnë në rritjen e konkurrencës së shoqërisë shoqëruar me uljen e shpenzimeve. Angazhimi për mbrojtjen e mjedisit është një kriter madhor në zgjedhjen e një prodhuesi kurse metoda me e thjeshtë dhe me efikasitet për të shfaqur kujdes ndaj problemeve lidhur me mjedisin është zbatimi i një sistemi manaxhimi për mjedisin në konformitet me parashikimet e standartit ndërkombëtar ISO14001. Perfitimet kryesore për këtë sistem manaxhimi janë: paraqitja e angazhimit për mbrojtjen e mjedisit nga klienti, investitorët potencialë, komuniteti, autoritetet; zvogëlimin e shpenzimeve nepermjet përmirësimit të administrimit mbeturinave dhe uljen e konsumit të burimeve; parandalimin e incidenteve të mundshme që mund të cojë në pagesën për demshperblim dhe dëm; përmirësimin e marrëdhënieve me autoritetet; mundësi për hyrje në tregje të reja. Për sa më sipër, vendosja e kësaj ISO është në proporcion me objektin që AK po prokuron.

Standarti ISO 45001 përfaqëson një standard ndërkombëtar që përcakton kërkesat për një sistem manaxhimi të shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të kompanisë me udhëzime për përdorimin e tij, për të mundësuar një organizatë që të përmirësojë në mënyrë proaktive performancën e shëndetit dhe sigurisë në punë të punonjësve të saj. Kjo ISO ka për qëllim të jetë

e zbatueshme për çdo organizatë përfshirë dhe subjektet tregtare pavarësisht nga madhësia, lloji dhe natyra e saj.

Në objektin e kontratës janë parashikuar shërbime, të cilat rrezikojnë në mënyre të vazhdueshme jetën dhe shëndetin e punonjësve që do të angazhohen, kështu që rrjedhimisht kërkesa për këtë certifikatë është një kërkesë e nevojshme.

Gjithashtu argumentojmë se, politikat e AGSco Sh.A. për sigurinë dhe shëndetin në punë kanë një rol thelbësor për të gjitha llojet e aktiviteteve që ushtrohen, kërkesa kjo si kontraktuale ndërmjet nesh edhe TAP ashtu edhe ndërmjet nesh edhe të gjithë palëve të treta (sic janë operatorët ekonomike) që lidhin kontratë me AGSco dhe do të kryejnë aktivitetet furnizimi, trajnimi dhe shërbimi.

2.2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë të lëshuar nga QKL me Kod III.2.B për ushtrimin e aktivitetit të transportit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo-te rrezikshme në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe listën e mbetjeve të përcaktuara në DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 41, pika 4, germa a) e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë liçencën profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, si dhe në Ligjin nr.10081, datë 23.2.2009 “Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar. Liçencimi i kategorisë III.2.B në VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për liçencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Liçencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, **transportim**, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.

2.2.6 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të vetedeklarojë se nëse do të jetë fitues do të paraqesë së bashku me dokumentacionin e ofertës, Tabelën (Lista e menaxhimit të kodeve, bashkelidhur DT, të plotësuar prej tij), si dhe kontratat e vlefshme të lidhura me subjekte të treta, të cilat sigurojnë ciklin e plotë të menaxhimit të integruar të mbetjeve, për listën e mbetjeve të përcaktuar në DT.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Autoriteti Kontraktor vlerëson se kërkesa për vetedeklarim dhe paraqitje të dokumentacionit përkatës nga operatorët ekonomikë, në rast shpalljeje fitues, është e domosdoshme dhe në lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, pasi synon të garantojë se operatori ekonomik fitues disponon kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale për realizimin e plotë dhe të pandërprerë të gjithë ciklit të menaxhimit të integruar të mbetjeve, nga grumbullimi deri në trajtimin përfundimtar të tyre.

Në këtë kuadër, operatori ekonomik duhet të sigurojë dhe të garantojë Autoritetin Kontraktor se menaxhimi i mbetjeve do të kryhet në mënyrë të plotë dhe në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, përfshirë, por pa u kufizuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, VKM nr. 418, datë 25.06.2014, “Për miratimin e listës së mbetjeve”, i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve, duke garantuar përmbushjen e detyrimeve ligjore gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë ne stafin e vet minimumi 3 (tre) punonjes me kualifikimet si më poshtë:

- 2 (dy) shoferë, të pajisur me leje drejtimi të vlefshme për kategoritë përkatëse të mjeteve që përdoren për transportin e mbetjeve. Të paktën njëri prej shoferëve duhet të jetë i pajisur me leje drejtimi dhe licencë ADR në fuqi, për drejtimin e mjeteve që transportojnë mbetje të rrezikshme, në përputhje me kërkesat e Marrëveshjes Evropiane për Transportin Rrugor Ndërkombëtar të Mallrave të Rrezikshme (ADR), të njohur dhe të vlefshme në Republikën e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës për të kryer aktivitetet operacionale në funksion të realizimit të shërbimit objekt kontrate.
- 1(një) Përgjegjës për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SShP), i cili mund të jetë një nga punonjësit e deklaruar më sipër ose të sigurohet nëpërmjet një kontrate të vlefshme me palë të tretë në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, dhe nuk konsiderohet personel shtesë për qëllime të këtij kriteri.

2.2.7.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqese për 1(një) punonjës që do të angazhohet drejtpërdrejt në aktivitetet në terren, dokumentacion provues për trajnimet ndërgjegjëse të lëshuara nga institucione trajnimi të licencuara ose të autorizuar nga ministria përgjegjëse, konkretisht:

- i. *Certifikatë trajnimi/dëshmi pjesëmarrje ne trajnim për mbrojtjen nga zjarri.*
- ii. *Certifikatë trajnimi për dhënien e ndihmës së parë.*

2.2.7.2 Certifikatë/vërtetim aftësie për punë e lëshuar nga mjeku kompetent për te tre punonjësit.

2.2.7.3 Certifikatë e lëshuar nga institucioni kompetent, për punonjësin e caktuar si përgjegjës ose koordinator për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, në përputhje me Ligjin nr. 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara në këtë kriter do të paraqiten nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas percaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në pikën 4 të nenit 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe në nenin 41, pikat 4/b) dhe 4/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, të Ligjit

nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, të cilat na japin të drejtën të përcaktojmë kriteret për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe rrezikut të shërbimeve që prokurohen.

Kërkesa për disponimin e një minimumi prej 3(tre) punonjësish është përcaktuar duke marrë në konsideratë shtrirjen gjeografike të objekteve ku realizohet grumbullimi i mbetjeve, konkretisht në qarqet Berat, Korçë, Tirane dhe Fier, si dhe natyrën dhe vëllimin e shërbimeve që do të kryhen, në përputhje me Termat e Referencës dhe preventivin përkatës.

Operatori Ekonomik duhet të realizojë transportin e mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme nëpërmjet automjeteve teknologjike përkatëse, të cilat do të drejtohen nga drejtues mjetesh të pajisur me dokumentacionin dhe kualifikimet përkatëse, në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e transportit dhe menaxhimit të mbetjeve.

Gjithashtu, Operatori Ekonomik duhet të disponojë 1 (një) punonjës që do të angazhohet në aktivitetet në terren dhe që do të shoqërojë drejtuesin e mjetit gjatë kryerjes së shërbimit, në funksion të realizimit të sigurt dhe korrekt të operacioneve.

Për më tepër, duke qenë se objekti i kontratës lidhet me kryerjen e shërbimeve që paraqesin rreziqe për sigurinë dhe shëndetin në punë, është e domosdoshme që Operatori Ekonomik të disponojë edhe 1 (një) person të certifikuar si përgjegjës/koordinator për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (HSE), i cili do të ketë për detyrë koordinimin, monitorimin dhe zbatimin e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Përcaktimi që disa nga këto funksione mund të përmbushen edhe nga i njëjti person, me kusht që ai të disponojë kualifikimet, certifikimet dhe dokumentacionin përkatës, është bërë me qëllim respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe për të mos krijuar kufizime të panevojshme në pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri i mësipërm është i nevojshëm, proporcional dhe i justifikuar nga natyra e objektit të kontratës, si dhe synon të garantojë realizimin e sigurt, cilësor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve, si dhe mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së punonjësve të përfshirë në këtë aktivitet.

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë në pronësi ose me qira minimalisht mjetet teknike për ekzekutimin me sukses të kontratës sipas tabelës më poshtë:

Nr.	Mjetet	Nr. min.	Argumenti teknik për çdo mjet dhe pajisje të kërkuar
1	Mjet teknologjik (Kamion mbledhes) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane. Kapaciteti minimal $\geq 12 \text{ m}^3$	1	Mjeti teknologjik (kamion) për mbledhjen dhe transportin e mbetjeve urbane do të përdoret për mbledhjen e mbetjeve të zyrave dhe urbane nga koshat dhe kontejnerët. Transporton në mënyrë të sigurt mbetjet drejt landfillit, stacionit të transferimit ose impiantit të trajtimit. Mjeti kërket me kapacitet minimal 12 m^3 nisur nga sasia e mbetjeve që gjenerohen në qendrat e mirëmbajtjes si dhe për të reduktuar numrin e udhëtimeve, kostot e transportit dhe rrezikun e aksidenteve rrugore.

2	Mjet transporti për transportin e mbetjeve të riciklueshme. Kapaciteti minimal $\geq 8 \text{ m}^3$	1	Mjeti për transportin e mbetjeve të riciklueshme do të shërbejnë për transportin e materialeve të ndara për riciklim (plastikë, letër, metal, qelq) ruajtjen e cilësisë së materialeve, duke shmangur përzierjen me mbetje të tjera dërgimin e mbetjeve në qendra riciklimi ose impiante përpunimi. Mjeti kërkohet me kapacitet minimal 8 m^3 nisur nga sasia e mbetjeve që gjenerohen në qendrat e mirembajtjes si dhe për të reduktuar numrin e udhëtimeve, kostot e transportit dhe rrezikun e aksidenteve rrugore.
3	Mjet transporti me kontenier për transportin e mbetjeve të rrezikshme, të mbyllur dhe të certifikuar sipas ADR Kapacitet minimal $\geq 5 \text{ m}^3$	1	Mjeti me kontejner për transportin e mbetjeve të rrezikshme do të përdoren për transportin e mbetjeve të rrezikshme (kimike, spitalore, industriale, vajra, bateri, etj.) parandalimin e ndotjes dhe rrezikut për shëndetin publik, falë kontejnerëve të mbyllur dhe të sigurt dhe respektimin e standardeve ligjore dhe mjedisore gjatë transportit. Janë shumë të rëndësishme për mbrojtjen e njerëzve dhe mjedisit dhe kapaciteti është vendosur minimal 5 m^3 nisur nga sasia e mbetjeve të rrezikshme që gjenerohen në qendrat e mirembajtjes.

Disponimin e këtyre mjeteve, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorëzimit të këtij dokumentacioni:

- i. Kontrata e blerjes së mjeteve ose qirase ose fatura e blerjeje.
- ii. Lejet e qarkullimit të mjeteve
- iii. Lejet e drejtimit të shoferëve të autorizuar
- iv. Sigurimet e mjeteve (TPL).
- v. Certifikatat e kontrollit teknik.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e mjeteve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas DT. Ndërsa dokumentacioni i kërkuar në këtë kriter do të paraqiten nga OE i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit sipas përcaktimeve të nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Argumentimi: Vendosija e këtij kriteri bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë në dispozicion ose që mund t’u vihen në dispozicion mjetet e nevojshme teknike për përmbushjen e kontratës, në funksion të natyrës, kompleksitetit dhe specifikave të shërbimeve objekt i prokurimit.

Referuar shërbimeve të parashikuara në Termat e Referencës dhe në preventivin përkatës, ku përfshihet menaxhimi i mbetjeve jo të rrezikshme dhe i mbetjeve të rrezikshme, si dhe vendodhja e objekteve ku do të grumbullohen këto mbetje Fier, Berat, Korce, Tirane por edhe vendodhjet e landfillëve në Shqipëri është e domosdoshme që transportimi i tyre të realizohet vetëm nëpërmjet mjeteve teknologjike të përshtatshme, të ndara sipas kategorive të mbetjeve, në përputhje me

kërkesat e legjislacionit në fuqi në fushën e menaxhimit të mbetjeve, mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë gjatë transportit. Argumentimi teknik i detajuar për çdo mjet pasqyrohet në tabelën e mësipërme.

Në këtë kuadër, Autoriteti Kontraktor vlerëson se kriteri është i nevojshëm, proporcional dhe i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, duke synuar garantimin e realizimit korrekt, me sukses dhe ligjor të shërbimeve të kërkuara.

Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim:

2.2.9 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 41/6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar ku parashikohet se: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

AGS SH.A është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike për Trans Adriatic Pipeline AG sipas Marrëveshjes së Mirëmbajtjes midis Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGSco. Ndaj AGSco në marrëdhëniet me biznesin, bazohet dhe ndjek parimet e besnikërisë, korrektësisë, transparencës, efikasitetit dhe tregut të lirë, parime këto të percaktuara jo vetëm në legjislacionin e prokurimit por edhe në Kodin e Etikës të shoqërisë. Në këtë Kod janë përcaktuar edhe rregullat mbi (praktikat korruptive, favoret e paligjshme, marrëveshjet e fshehta dhe kërkesat për përfitime personale për veten ose të tjerët etj.), që grupet e interesit (përfshirë ofertuesit) duhet t’i vlerësojnë nëse ato kërkojnë të bashkëpunojnë me AGS SH.A, prandaj përpara se operatorët ekonomikë të ofertojnë duhet të njihen dhe marrin përsipër t’i zbatojnë këto rregulla. Për më tepër, argumentojmë se këto rregulla nuk bien ndesh me rregullat e prokurimit publik, prandaj është vlerësuar nga ana jonë edhe vendosja e kriterit se operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë se do zbatojë rregullat e percaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A që kanë lidhje me realizimin e objektit të kësaj kontrate.

II. Argumentimi i termave të referencës dhe specifikimet teknike

Termat e referencës janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e AK, natyrën e mallrave dhe afatin kohor për realizimin e këtij furnizimi, në nenin 36 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në nenin 41 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Ligjin nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” i ndryshuar, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe mbrojtjes së mjedisit. AGS SH.A. është një shoqëri shërbimesh operative, përgjegjëse për kryerjen e veprimtarisë së mirëmbajtjes dhe shërbimeve teknike të tubacioneve të gazit për Trans

Adriatic Pipeline AG, në zbatim të Marrëveshjes së Mirëmbajtjes së lidhur ndërmjet Trans Adriatic Pipeline AG dhe AGS.

Gjatë ushtrimit të aktivitetit të saj në qendrat e mirëmbajtjes Fier, Berat, Korçë dhe Tiranë, gjenerohet një sërë mbetjesh të rrezikshme dhe jo të rrezikshme, të cilat përbëjnë detyrim ligjor për t'u menaxhuar nga AGS SH.A në përputhje me Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar, me VKM nr. 418, datë 25.06.2014, "Për miratimin e listës së mbetjeve", i ndryshuar, si dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të mbetjeve. Bazuar në llojet e mbetjeve që gjenerohen, në përvojën e mëparshme të shoqërisë, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, janë hartuar shërbimet përkatëse në termat e referencës dhe lista me kodet e mbetjeve në preventivin mbi bazën e të clit do të merren ofertat ekonomike gjatë testimit të tregut.

Afati i kësaj marreveshje kuader do të jete deri me 31.12.2026 per shkak se edhe kontrata e Autoritetit Kontraktor me klientin tone TAP perfundon me date 31.12.2026.